

BIODIVERSITETI DHE RËNDËSIA E TIJ

Çfare është Biodiversiteti?

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon apo në gjithë globin, ose shprehur ndryshe biodiversiteti paraqet llojlojshmërinë jetësore në tokë. Jeta e gjallë në tokë ka nivele të ndryshme të llojlojshmërisë duke filluar nga ADN-ja, llojet, popullacionet dhe ekosistemi.

Sipas të dhënave shkencore në tërë botën deri me tani janë identifikuar 1.75 milion lloje. Por vlerësimet e përgjithshme të shkencës janë se ekzistojnë edhe miliona lloje të pafundit, shumica e të cilave gjenden në vendet tropikale (vlerësohet se numri i llojeve mund të jetë mbi 5 milion).

Humbja e biodiversitetit si problem global

Biodiversiteti përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në bote. Është vlerësuar se rrjedha në këtë trend të kërcënimit të ekosistemeve natyrore do të paraqes rrezik për të ardhmen e njerëzimit dhe mund të sjell pasoja të rënda në natyrë.

Ndonëse kanë kaluar 14 vite që nga nënshkrimi i Konventës ndërkombëtare për Biodiversitetin të mbajtur në Rio de Janeiro ku ndër parimet kryesore të miratuara ka qenë edhe “ruajtja e vitalitetit dhe shumëllojshmërisë biologjike të jetës në tokë dhe përdorimi racional i resurseve natyrore”, problemi i ruajtjes së biodiversitetit vazhdon të jetë edhe sot shumë i theksuar.

Sipas të dhënave më të reja shkencore që nga vitin 1992 kur u mbajt Samiti i Rios, rreth 11.4 % e mjediseve të paprekura në botë janë ndryshuar nga njeriu. Supozohet se vetëm në 50 vitet e fundit, veprimet e njeriut kanë ndryshuar diversitetin e jetës në planet me tepër se çdo etape tjetër të historisë së njerëzimit.

Te dhënat flasin se vetëm në 100 vitet e fundit, zhdukja e specieve të shkaktuara nga njeriu është shtuar rreth 1000 here. Po ashtu rreth 12 % e shpendëve, 23 % e gjitarëve, 25 % e haloreve dhe 32 % e ujëtokësorëve kërcënohen për zhdukje, ndërkaq që rezervat peshkore të botes janë reduktuar deri në 90 % që nga fillimi i industrisë së peshkimit.

Ekspertet supozojnë se nëse do të vazhdohet me këtë trend , humbja e biodiversitetit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25-30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % të llojeve të njohura në planet. Pasoja e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonomine botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40 % e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike.

Ekzistojnë shumë faktorë të cilët janë shkaktarë të zhdukjes së llojeve, por më të theksuarit janë: rritja e numrit të popullsisë në botë, shkalla e lartë e shpyllëzimit të sipërfaqeve të pyjeve, tharja e moçaleve, zhvillimi i hovshëm industrial, ngrohja globale, shirat acidike etj.

Domosdoshmëria e ruajtjes së biodiversitetit

Ruajtja e biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shumë arsye, por me këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre:

- Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moral që t'iu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë,
- Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu; qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri,
- Shume lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje të kësaj vlere,
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe jetës në planetin tonë,
- Biodiversiteti dhe llojshmëria biologjike e natyrës paraqet një potencial të larta për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi,
- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike,
- Dhe mbi të gjitha vetë Jeta e njerëzimit në tokë është e varura nga biodiversiteti-shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.